



QENDRA SPITALORE UNIVERSITARE  
"NËNË TEREZA"

---

# RAPORTI VJETOR I VEPRIMTARISË

---

2016

---

TIRANË

---

## **I. Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2016**

Viti 2016 mund të konsiderohet si viti i risive organizative dhe zhvillimeve të QSUT. Gjatë 2016 u zbatua një strukturë e re organizative që ka pasur si synim të vetin menaxhimin më të mirë të organizatës dhe një ribalancim ndërmjet funksioneve bazë: ato mjekësore, dhe funksioneve ndihmëse. Për herë të fundit struktura e QSUT ishte miratuar në vitin 2008 dhe ishte vënë re që nuk i përgjigjej zhvillimeve të ndodhura gjatë këtyre viteve. Prurjet kryesore të strukturës së re janë:

- Rritja e numrit të mjekëve dhe e stafit infermieror, për t'iu përgjigjur rritjes së ndjeshme të pacientëve spitalor dhe ambulator, të trajtuar në QSUT;
- Ulje e personelit ndihmës/mbështetës për të cilin zhvillimi teknologjik ose kontraktimi i shërbimeve me operator privat mundësonin reduktimin e stafit të QSUT.

Në këtë mënyrë QSUT do të fokusohet në objektin e saj primar, atë të ofrimit të shërbimit ndaj pacientëve ndërsa aktivitetet ndihmëse të ofruara nga tregu. Kjo strukturë e re është shoqëruar me një rregullore të re të funksionimit të institucionit dhe Kodin Etik. Qendra Spitalore Universitare në veprimtarinë e saj, gjatë vitit 2016, ka orientuar punën e saj në shërbimet mjekësore dhe ato jo mjekësore por të lidhura me pacientët në disa drejtime:

- ✓ Mirë administrimi i fondeve në mbështetje të shërbimeve mjekësore spitalore
- ✓ Optimizimi i proceseve të punës për të siguruar shërbime mjekësore të përshtatshme dhe cilësore për pacientët
- ✓ Sigurim i furnizimit në vazhdim me barna dhe materiale mjekësore
- ✓ Sigurim i sistemit të mirëmbajtjes së pajisjeve biomjekësore
- ✓ Laboratorë funksionale për pacientët e shtruar dhe ambulatorë
- ✓ Rritje e nivelit të realizimit të të ardhurave dytësore
- ✓ Përmirësim i ambienteve spitalore dhe sigurim i kushteve të punës normale për stafin mjekësor

### **Në aspektin e investimeve kyçe:**

Arritëm realizimin e investimeve në masën 98.5% për vitin 2016.

- ✓ Përfunduar ndërtimin e bunkerit të ri për akseleratorin linear, në shërbimin e onkologjisë (QSUT) me kapacitet për dy njësi, investimi për vitin 2016 në shumën 48,203,221 lekë, fonde të buxhetit të shtetit.
- ✓ Përfundoi mobilimi spitalor i Bunkerave të Akseleratorit Linear të Spitalit Onkologjik dhe Spitalit të Neurokirurgjisë në vlerën 5,439,905 lekë, fonde të siguruara nga të ardhurat dytësore.
- ✓ Përfunduar punën për ndërtimin e Godinës së Konsultave Ambulatore një qendër e re konsultash e cila ka centralizuar shërbimin ambulator, duke siguruar një administrim më të mirë të shërbimit të konsultës me një sistem unik të prenotimeve

on-line. Investim i filluar në 2015 dhe përfunduar në 2016, me vlerë investimi për këtë vit 36,124,332 lekë, fonde të buxhetit të shtetit.

- ✓ Mobilimi spitalor i Godinës së Konsultave Ambulatore me një vlerë investimi 14,519,200 lekë, fonde të siguruara nga të ardhurat dytësore.
- ✓ Përfundoi përshtatja e ambientit të vendosjes së SPEC CT në Qendrën e Mjekësisë Bërthamore në vlerën 4,372,302 lekë, fonde të siguruara nga të ardhurat dytësore.
- ✓ Mbërritja e Spec CT një pajisje e cila mundëson vlerësimin anatomik dhe funksional të trupit me përdorim të gjerë në onkologji, kardiologji, endokrinologji, nefrologji, reumatologji, urologji, neurologji etj, investim në vlerën 73 milion lekë dhe pagesë TVSH-je në vlerën 16 milion lekë, pagesë e cila u mundësua nga të ardhurat dytësore.

**Në aspektin mjekësor, për herë të parë gjatë vitit 2016 vlen të përmendet që** tashmë prej një viti, funksionon 24/7, Urgjenca Kardiake. Në krahasim me vitin 2013, kemi një shtim me 30% të numrit të koronarografive të kryera, dhe më shumë se 930 jetë të shpëtuar, vetëm në Sistemin e Urgjencës Kardiake.

Investimi i Qeverisë në ndërtimin e Njësisë së re të Radioterapisë në Spitalin Onkologjik, është një prej ndërhyrjeve më efikase, në lidhje me trajtimin bashkëkohor të sëmundjeve tumorale. Prej muajit prill 2015 e në vazhdim, njësia e Akseleratorit linear, ka përmirësuar rrenjësisht modelin e trajtimit të sëmundjeve tumorale, nëpërmjet radioterapisë. Sot trajtohen rreth 50 pacientë/ditë, së bashku me akseleratorin në shërbimin e Neurokirurgjisë, njësi e cila ka trajtuar rreth 300 pacientë në radioterapi dhe rreth 90 pacientë në radiokirurgji. Gjatë vitit 2017 presim akseleratorin e dytë linear, një investim i përbashkët i Qeverisë Shqiptare dhe Agjencisë së Energjisë Atomike. Do të jetë hapi final në arritjen e një standardi të ri, si një qendër spitalore europiane, në trajtimin me rreze të tumoreve.

Po në Spitalin Onkologjik, kemi kryer një transformim të mirëfilltë të Spitalit ditor të Kemioterapisë. Me infrastrukturë bashkëkohore dhe me pajisje speciale për terapitë, ai ofron shërbim për rreth 40 pacientë në ditë, përmes një sistemi me dy turne, për të lehtësuar pritjen dhe trajtimin e pacientëve.

Për vitin 2016, QKA ka ofruar rreth 445 mijë shërbime ambulatore për rreth 345 mijë pacientë.

Punuam intensivisht për trajtimin e Urgjencave Cerebro-Vaskulare, 24/7. Pas përfundimit të investimit në infrastrukturën e Spitalit të Neurologjisë, Shërbimi Neurovaskulat / Stroke Unit, siç njihet ndryshe, është një ndër prioritetet tona. Kemi filluar me trajnimin e strukturave shëndetësore, si edhe futjen e protokolleve të reja të mjekimit, që do të kryhen në këtë shërbim.

Ndërkohë, partneriteti publik-privat ka sjellë një përmirësim të dukshëm të shërbimit kirurgjikal, ku QSUT-ja është si një rast sukcesi në vënien në zbatim të tij. Është padyshim hapi i parë drejt zhvillimit të një sistemi të ri, apo futjes së proceseve të reja, që më parë nuk njiheshin në sistemin tonë spitalor. Instrumentat e reja, sterilizimi i tyre, veshjet njëpërdorimëshe, evadim i tyre duke i kthyer në mbetje urbane, sterilizimi i sallave të operacionit në fund të ditës, janë të gjitha risi, impakti i të cilave është ndjerë në uljen e infeksioneve spitalore, kursimin e kohës së stafit infermieror që do të thotë më shumë kujdesje për pacientin në sallë, shkurtimin e kohës së operacioneve dhe përmirësimin e efikasitetit të trajtimeve kirurgjikale, duke rritur dhe numrin e ndërhyrjeve në 25,230 ndërhyrje ose 6,6 % më shumë se viti 2015.

## II. ADMINISTRIMI I QSUT

### 1. Treguesit financiar

Gjatë vitit financiar 2016, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza” ka pasur një buxhet total prej 6,259,639,230 lekë, i financuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në vlerën 85,441,230 lekë për sa i përket zërit të investimeve dhe nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor në vlerën prej 6,174,198,000 lekë për zërat mallra dhe shërbime, paga dhe sigurime shoqërore. Buxheti i akorduar për zërin 602 është realizuar në masën 99.5 %, ndërsa buxheti i akorduar për zërin 600 dhe 601 në masën 97.6%. Në tabelën në vijim jepen të detajuara destinacioni dhe mënyra se si është shpenzuar buxheti i akorduar nga ana e QSUT.

Shpenzimet për mallra dhe shërbimi kanë përbërë rreth 67.13% të buxhetit total të QSUT, ndërsa pjesa tjetër prej 32.87 % kanë qenë shpenzime për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësore dhe investime, përkatësisht 27% paga dhe sigurime dhe 1.36% investime.

Nr.	Emertimi	Vlera	Në % ndaj 602	Në % ndaj TOTALIT
1	Barna	2,474,527,523	59%	39.53%
2	Oksigjen shëndëtsor	99,422,572	2%	1.59%
3	Protoksid Azoti	9,765,101	0%	0.16%
4	Mirmb.Pajisje mjekësore	313,596,841	7%	5.01%
	<b>SHUMA</b>	2,897,312,037		
5	Gjithë të tjerat	1,304,749,963	31%	20.84%
	<b>SHUMA</b>	4,202,062,000	100%	67.13%
6	Paga	1,691,030,000		27.01%
7	Sigurime shoq. e shënd.	281,106,000		4.49%
8	Investime	85,441,230		1.36%
	<b>TOTALI</b>	6,259,639,230		100%

Nëse do t’i referohemi zërit mallra dhe shpenzime vërejmë se pjesa kryesore e shpenzimeve të këtij zëri ka qenë e destinuar për blerjen e barnave dhe materialeve mjekësore. Shpenzimet për barna dhe materiale mjekësore gjatë vitit 2016 përbënë rreth 59% të fondeve sipas zërit mallra dhe shpenzime (Artikulli 602) ose rreth 39.53 % të buxhetit total të QSUT.

#### 1.1. Plani i investimeve

Për sa i përket investimeve, gjatë vitit 2016 në QSUT puna është përqëndruar në përfundimin e projekteve të nisura që më parë por edhe në disa projekte të reja ndërtimore dhe furnizim vendosje pajisjesh mjekësore për Shërbimet e QSUT. Konkretisht gjatë vitit 2016 ka përfunduar punimet për ndërtimin e bunkerit pranë Shërbimit Onkologjik në të cilin do të instalohen dy akseleratorët linear. Gjithashtu gjatë vitit 2016 kanë vijuar edhe punimet për rikonstruksionin e godinës së ish laboratorëve dhe shndërrim e kësaj godine në Qendrën e

Konsultave të QSUT. Gjithashtu për dy godinat e sipërcituar (bunkeri i akseleratorit dhe godina e konsultave) janë prokuruar edhe mobiljet për pajisjen e tyre si dhe pajisjet kompjuterike për godinën e konsultave.

Gjithashtu në këtë vit është punuar për projektin për ndërtimin e një Depoje të re Farmaceutike në QSUT si dhe një projekt tjetër për rikonstrukcionin e fasadave të QSUT.

Vlera totale e investimeve të alokuara nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale është 85,441,230 lekë, prej së cilave QSUT ka arritur të realizojë investimet në masën 84,327,553 lekë, ose e thënë ndryshe me një normë realizimi prej 98.69 %. Në tabelën në vijim jepet një informacion më i detajuar lidhur me projektet e investimit, financimin e tyre si dhe nivelin e realizimit të këtyre projekteve gjatë vitit 2016.

	Emërtimi i projektit	Vlera e Plotë e projektit me TVSH	BUXHETI 2016		
			Plani i çelur për 2016	Vlera e Prokuruar me TVSH	Vlera e realizuar
1	Ndërtim bunkeri për instalimin e dy akseleratorëve linear në Spitalin Onkologjik	218,472,455	8,988,230	8,988,230	8,988,230
2	Supervizion për ndërtimin e Bunkerit për instalimin e dy akseleratorëve linear në Spitalin Onkologjik në QSUT	2,624,400	1,100,000	1,100,000	1,100,000
3	Ndërtim bunkeri për instalimin e dy akseleratorëve linear në Spitalin Onkologjik-Shtesë Kontrate	42,690,219.2	38,694,000	37,688,991	37,688,991
4	Supervizion +kolaudim për ndërtimin e Bunkerit për instalimin e dy akseleratorëve linear në Spitalin Onkologjik në QSUT-Shtesë Kontrate	494,000	494,000	426,000	426,000
5	Rikonstrukcion i ndërtesës së ish-Laboratorëve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT	58,027,844	24,928,000	58,027,844	24,928,000
6	Supervizion + kolaudim i Rikonstrukcionit të ndërtesës së ish-Laboratoreve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT	54,000	54,000	54,000	14,000
7	Rikonstrukcion i ndërtesës së ish-Laboratorëve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT(shtesë kontrate)	11,183,000	11,183,000	11,182,332	11,182,332
			<b>85,441,230</b>		<b>84,327,553</b>

Gjatë vitit 2016 në QSUT janë kryer edhe investime të tjera të realizuara nga të ardhurat dytësore të vetë institucionit. Investimet e kryera gjatë vitit 2016 të realizuara me të ardhurat dytësore janë 48,523,254 lekë. Më poshtë paraqiten investimet e detajuara.

	<b>Emertimi i projektit</b>	<b>Fondi i celur 2016</b>	<b>Likuiduar 2016</b>
1	Supervizion për ndërtimin e Bunkerit për instalimin e dy akseleratorëve linear në Spitalin Onkologjik në QSUT	24,400	24,400
2	Rikonstruksion i ndërtesës së ish- Laboratorëve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT	28,767	28,767
3	Kolaudim i Rikonstruksionit të ndërtesës së ish- Laboratorëve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT	66,000	66,000
4	Supervizim Rikonstruksionit të ndërtesës së ish- Laboratorëve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT (kontrata shtesë)	7,680	7,680
5	Kolaudim i Rikonstruksionit të ndërtesës së ish- Laboratorëve për përshtatje për qendrën e konsultave në QSUT (kontrata shtesë)	10,200	10,200
6	Hartim projekt preventiv për përshtatjen e ambientit për instalimin e aparaturës së Spec-CT në Qendrën e Mjekësisë Bërthamore	252,000	252,000
7	Përshtatja e ambientit për instalimin e aparaturës së Spec-CT në Qendrën e Mjekësisë Bërthamore	4,694,467	4,372,302
8	Supervizion Përshtatja e ambientit për instalimin e aparaturës së Spec-CT në Qendrën e Mjekësisë Bërthamore	73,800	73,800
9	Kolaudim Përshtatja e ambientit për instalimin e aparaturës së Spec-CT në Qendrën e Mjekësisë Bërthamore	4,800	4,800
10	Pajisje mobilimi spitalor për godinen e Qendrës së Konsultave në QSUT	14,530,000	14,519,200
11	Pajisje mobilim spitalor i Bunkerave të Akseleratorit Linear të Spitali Onkologjik dhe në Spitalin e Neurokirurgjisë	5,439,905	5,439,905
12	Projekt preventiv zbatimi për rikonstruksionin e fasadave të godinave ekzistuese të QSUT	2,736,000	
13	Projekt preventiv zbatimi për ndërtimin e depos qëndrore të barnave në QSUT	3,252,000	3,252,000
14	Hartim i studimit hidro- gjeologjiko-sizmik në kuadër të hartimit projekt preventiv zbatimi për ndërtimin e depos qëndrore të barnave në QSUT	300,000	300,000
15	Hartim i studimit për rilevimin topografik në kuadër të hartimit projekt preventiv zbatimi për ndërtimin e depos qëndrore të barnave në QSUT	107,400	107,400
16	Pagesë TVSH për pajisjen SPECT-CT	16,634,922	16,634,922
17	Pagesë TVSH për lëndë radioaktive	51,518	51,518
18	Furnizim me pajisje imobilizuese Breast STEP për Akseleratorin Linear "ELEKTA" të instaluar në Shërbimin Onkologjik	1,183,200	1,183,200
19	Furnizim vendosje monitor EKO	144,000	144,000
20	Blerje rafte archive	526,800	526,800
21	Blerje pajisje aksesori spitalor për përdorim mjekësor dhe shërbim ndaj pacientit	7,027,560	1,524,360

<b>Totali</b>	<b>57,095,419</b>	<b>48,523,254</b>
---------------	-------------------	-------------------

## **1.2. Të ardhurat dytësore të realizuar**

Në kuadër të zbatimit të sistemit të referimit në QSUT janë ngritur dhe funksionojnë 17 recepsione dhe arka. Të gjithë pacientët që nuk përfitojnë sipas sistemit të referimit i nënshtrohen tarifave të përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2016, pavarësisht reduktimit të tarifave të sistemit të referimit, kanë një vlerë totale prej 54,766,500 lekë. Këto të ardhura janë tejet të rëndësishme për QSUT pasi janë të ardhura jashtë limitit dhe mund të mbarten dhe përdoren nga vetë QSUT. Në çdo rast përdorimi i këtyre të ardhurave është bërë në përputhje me Udhëzimin e Nr. 2, datë 11.02.2014 të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.

Duhet theksuar se si pasojë e mirëadministrimit të punës në këto arka është arritur që vlera e këtyre të ardhurave të realizuara të rritet ndjeshëm në periudhën 2014-2015 krahasuar me periudhën 2012-2013. Gjithashtu këto të ardhura kanë një reduktim të lehtë nga viti i kaluar për efekt të reduktimit të tarifave të përcaktuara nga Urdhëri Nr. 28 datë 26.01.2016 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për sistemin e referimit dhe tarifat e shërbimit shëndetësor publik”.

Ndërsa në tabelën në vijim jepen të detajuara këto të ardhura sipas arkave dhe shërbimeve përkatëse për periudhën 2012 – 2016.

<b>EMËRTIMI</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>
<b>KONSULTAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>3,024,500</b>	<b>1,846,100</b>	<b>2,504,200</b>	<b>2,722,700</b>	<b>6,609,300</b>
<b>SPITALI FRANCEZ</b>	<b>4,952,700</b>	<b>3,450,100</b>	<b>6,589,100</b>	<b>7,118,500</b>	<b>8,224,200</b>
<b>SPITALI NR.1 (6 KATËSHI)</b>	<b>5,538,200</b>	<b>5,971,000</b>	<b>9,130,000</b>	<b>10,634,900</b>	<b>10,746,800</b>
<b>SPITALI NR.2</b>	<b>4,442,700</b>	<b>4,510,050</b>	<b>6,314,200</b>	<b>7,094,400</b>	<b>3,021,700</b>
<b>SPITALI NR.3 (PEDIATRIA)</b>	<b>1,800,900</b>	<b>1,373,100</b>	<b>2,382,800</b>	<b>2,556,500</b>	<b>2,606,500</b>
<b>SPITALI NR.4 (INFEKTIVI)</b>	<b>596,100</b>	<b>464,700</b>	<b>485,200</b>	<b>1,383,800</b>	<b>1,221,400</b>
<b>SPITALI NR.5 (NEUROLOGJIA)</b>	<b>869,500</b>	<b>440,000</b>	<b>245,000</b>	<b>1,373,500</b>	<b>1,325,300</b>
<b>SPITALI ONKOLOGJIK</b>	<b>4,265,100</b>	<b>3,099,300</b>	<b>4,973,600</b>	<b>4,855,300</b>	<b>3,785,700</b>
<b>SPITALI ORTOPEDIK</b>	<b>1,004,400</b>	<b>670,860</b>	<b>972,100</b>	<b>1,264,700</b>	<b>1,529,500</b>
<b>KARDIOKIRURGJIA</b>	<b>1,183,970</b>	<b>1,117,400</b>	<b>921,000</b>	<b>1,691,400</b>	<b>477,600</b>
<b>LABORATORI QENDROR</b>	<b>1,731,600</b>	<b>800,400</b>	<b>2,687,000</b>	<b>1,955,000</b>	<b>1,403,000</b>
<b>IMAZHERIA</b>	<b>858,700</b>	<b>667,200</b>	<b>1,069,900</b>	<b>1,095,500</b>	<b>1,149,200</b>
<b>SPITALI NR3/1</b>	<b>782,300</b>	<b>735,500</b>	<b>926,000</b>	<b>1,004,000</b>	<b>876,300</b>
<b>SPITALI NR.5/1 (NEUROKIRURGJIA)</b>	<b>2,075,000</b>	<b>2,019,000</b>	<b>3,565,000</b>	<b>3,617,000</b>	<b>3,217,700</b>
<b>ISKSH</b>	<b>13,374,450</b>	<b>14,426.30</b>	<b>12,909,000</b>	<b>13,308,900</b>	<b>2,283,700</b>
<b>REUMATOLOGJIA</b>	<b>1,201,600</b>	<b>582,500</b>	<b>785,000</b>	<b>1,333,500</b>	<b>545,000</b>
<b>SPITALI I RI</b>	<b>1,097,500</b>	<b>1,376,800</b>	<b>5,405,500</b>	<b>3,275,200</b>	<b>4,294,100</b>
<b>PSIKIATRIA</b>					<b>1,449,500</b>
<b>TOTALI</b>	<b>48,799,220</b>	<b>43,550,310</b>	<b>61,864,600</b>	<b>66,284,800</b>	<b>54,766,500</b>

Përveç të ardhurave dytësore të realizuara si pasojë e zbatimit të sistemit të referimit, QSUT realizon edhe të ardhura të tjera kryesisht prej parkimit brenda territorit të QSUT. Theksojmë se parkimi i është dhënë me koncesion një subjekti privat dhe të ardhurat nga parkimi janë në vlerë fikse sipas termave të koncesionit për operator ekonomik. Në tabelën në vijim jepen të ardhurat totale të realizuara nga QSUT për vitin periudhën Janar – Dhjetor 2016.

Lloji i te ardhurave	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nentor	Dhjetor	Totali
Qera	658,100	610,703	640,555	737,527	926,595	723,479	601,923	3,443,518	666,180	511,326	734,616	575,583	10,830,105
Sherbimi Ambulator	2,112,850	2,311,950	2,149,500	2,125,150	1,918,950	1,772,000	1,356,300	1,439,600	1,641,900	1,711,900	1,855,800	1,477,100	21,873,000
Konsultra ISKSH	4,052,650	4,235,250	2,753,100	2,710,000	2,630,000	2,649,300	2,139,700	2,192,600	2,740,800	2,410,200	2,206,700	2,173,200	32,893,500
Parking	810,000	810,000	810,000	810,000	543,307	810,000	810,000	1,076,693	810,000	810,000	810,000	810,000	9,720,000
													<b>75,316,605</b>

### **Burimet njerëzore**

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore është menaxhimi i fuqisë punëtore. Ai është përgjegjës për tërheqjen, selektimin, dhe menaxhimin e punonjësve, ndërkohë që gjithashtu mbikqyr shpërndarjen e burimeve njerëzore në raport të drejtë me kërkesat dhe nevojat e shërbimeve për personel, duke respektuar numrin e miratuar me Vendimin nr.5, datë 21.09.2015, “Për miratimin e strukturës administrative dhe mjekësore dhe organigramës së Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, të Bordit Drejtues të Spitaleve Universitare si dhe ndryshimeve të miratuar me shkresë Nr.Prot. 4404/1, datë 28.09.2016, shkresë Nr.Prot. 6431, datë 30.11.2016, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Drejtoria e Burimeve Njerëzore funksionon në pajtueshmëri me Ligjin Nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Statutit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me Nr.Prot.2364 dt. 25.06.2007 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Nr.Prot. 4564/1 dt 26.06.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Vendimit nr.7, datë 21.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së funksionimit të Q.S.U.T.” i Bordit Drejtues të Spitaleve Universitare, Kodit Etik të miratuar me Nr.Prot. 3206, datë 11.06.2015, “Për punonjësit e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Bazuar në ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar si dhe të gjitha V.K.M, Urdhëresat apo aktet e tjera nënligjore.

Me Vendim Nr.5, datë 21.09.2015, Bordi Drejtues i Spitaleve Universitare miratoi për QSUT në total 2980 punonjës. Me Urdhër Nr. 279, datë 29.09.2015, “ Për krijimin e Komisionit të Ristrukturimit, në kuadër të restrukturimit administrativ dhe mjekësor të QSUT”, u ngrit grupi i punës i cili u ngarkua me zbatimin strukturës. Në respektim të Kodit të Punës, rifilluan procedurat për ekzekutimin e kësaj strukture, nga ku rezulton se përgjatë periudhës Shtator 2015 – Qershor 2016, janë realizuar **83** transferime dhe **36** suprimime.

Janë rreth 8 persona të cilët ndoqën në rrugë ligjore, ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të suprimimit të pozicionit që mbulonin, nga ku 6 raste u fituan për shkak të procedurave korrekte të ndjekura dhe 1 person është akoma në proçes.



Gjithashtu përgjatë vitit 2016 kjo strukturë ka pësuar ndryshime të cilat janë miratuar me Urdhër Nr. 29, datë 26.01.2016 “ Për miratimin e numrit të punonjësve në spitalet publike të vendit, për vitin 2016, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nga ku rezulton një rritje e numrit total të punonjësve nga **2980** në **3022** punonjës. Me shkresë Nr.Prot 6431, datë 30.11.2016, të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ky numër ndryshon nga **3022** në **3042** punonjës. Përveç rasteve të transferimeve dhe suprimimeve ka patur dhe emërimë, jo vetëm për të plotësuar pozicionet e reja të krijuara por edhe për të plotësuar nevojat dhe kërkesat e shërbimeve për shkak të vendeve vakante të krijuara nga largimet e personelit me daljen në pension apo largimeve me dëshirë. Kjo strukturë e miratuar dhe të gjitha lëvizjet e personelit janë reflektuar në sistemin online të vënë në dispozicion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Bazuar në Vendimin Nr. 7, datë 21.09.2015 “Për miratimin e Rregullores së Funkcionimit të QSUT” mbi procedurat e punësimit si dhe në Udhrin Nr.Prot. 355, datë 18.08.2014, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale “Për kriteret e punësimit të mjekëve në spitalet universitare”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore për punësimin e personelit ka organizuar rreth 48 konkurse, nga të cilat 16 konkurse për personel mjekësor, 5 konkurse për personel infermieror dhe 27 konkurse për personel administrativ. Bazuar në detyrat funksionale të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore mbi menaxhimin e dosjeve të personelit, është vënë një theks i veçantë në plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentat përkatëse përpara daljes së vendimit të emërimit.

Gjithashtu është organizuar menaxhimi i dosjeve sipas Poleve të Administrimit të Integruar si dhe filloi procesi i zbardhjes së dosjeve sipas PAI-eve, e cila do të shtrihet edhe përgjatë vitit 2017, me qëllim plotësimin e të gjitha dosjeve të personelit me dokumentacionin e kërkuar. Bazuar në ligjin Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore”, i ndryshuar, në vitin 2016 kanë dalë në pension të gjitha femrat e datëlindjes 1956 dhe meshkujt e datëlindjes 1951. Referuar listës emërore të personelit dhe ligjit të sipërcituar kanë dalë në pension 90 persona, ndër të cilët 80 janë femra dhe 10 janë meshkuj. Bazuar në shkresën Nr. 1151/1 datë 29.03.2016 të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, janë miratuar 160 mjekë pedagogë. Pas vlerësimit të bërë, nisur dhe nga shkresat e shërbimeve, janë lidhur kontratat e shërbimit me 144 pedagogë ndër të cilët 133 janë mjekë pedagogë të Fakultetit të Mjekësisë dhe 11 janë mjekë pedagogë të Fakultetit të Infermierisë. Gjatë vitit 2016 kanë ofruar shërbimin si mjekë vullnetarë 32 persona.

## **2. Shërbimet mbështetëse**

Struktura tejet e madhe e QSUT-së dhe numri i pacientëve të cilët marrin shërbim spitalor në të vetmen qendër terciare në vend, bëhet e domosdoshme pasja e një infrastrukture të përshtatshme në mbështetje të ekipit mjekësor që do të ofrojë shërbimin për pacientët. Në QSUT vepron një drejtori e veçantë e cila ka në themel të punës së saj, sigurimin dhe monitorimin e kontratave të shërbimit dhe furnizimit, për ofrimin e një shërbimi cilësor në funksion të shërbimeve mjekësore. Mirëmbajtjen e të gjithë infrastrukturës spitalore, ndërtimore dhe asaj të impiantistikës, por edhe ofrimin e një shërbimi sa më cilësor të hotelierisë në të gjithë spitalet e QSUT.

Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse ka për objekt të punës së saj pikërisht sigurimin e vazhdimësisë së shërbimit mjekësor, duke e mbështetur në mirëmbajtjen ndërtimore të godinave spitalore, mirëmbajtjen e impiantistikës, mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbërta dhe pastrimin e jashtëm, sigurimin e shërbimit të transportit me ambulancë, të furnizimit me oksigjen dhe lëndë djegëse siguruar, si dhe duke ofruar shërbimin e ushqimit dhe të lavanderisë, ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve spitalore dhe atyre ndihmëse.

### **3. Marrëdhëniet juridike dhe procedurat e prokurimit publik**

Sektori i Prokurimeve si sektori me peshën më specifike të kësaj drejtorie në zbatim të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe të VKM-së Nr. 914, datë 29/12/2014, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ka realizuar me sukses të gjitha prioritetet dhe detyrat funksionale bazuar në Statutin e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” me Nr. 2364 Prot, datë 25.06.2007 të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nr. 4564/1 Prot, datë 26.06.2007 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Rregulloren bazë të funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, miratuar me vendimin Nr.7 datë 21.09.2016, me Nr. 3205/6 Prot., “Për miratimin e rregullores së funksionimit të Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza” të Bordit Drejtues të Spitaleve. Ka realizuar në masën **100%** të gjitha procedurat e prokurimit publik të parashikuara në regjistrin e parashikimeve të vitit 2016, konform legjislacionit të prokurimit publik, duke plotësuar të gjitha nevojat për mallra, shërbime si dhe punë të QSUT-së. Gjatë gjithë vitit 2016 (Janar –Dhjetor) nga ky sektor janë zhvilluar rreth **164** procedura “**Negocim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës (20%)**” të përdorura për plotësimin e nevojave të fillim vitit 2016, deri në përfundimin e procedurave të prokurimit të vitit 2016.

Janë realizuar rreth **5 procedura me Negocim pa Shpallje Paraprake të njoftimit të kontratës** (Emergjencat) të deleguara me autorizim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në rolin e Organit Qendror Blerës për blerje Barna dhe Materiale mjekësore të përgjithshme për mbulimin e nevojave për periudhën shkurt - prill 2016, deri në përfundimin e procedurave të prokurimit të nisura por ende të papërfunduara nga MSHMS. Janë realizuar rreth **5 procedura me Negocim pa Shpallje Paraprake të njoftimit të kontratës** (për mbulimin e nevojave deri në realizimin e procedurës së prokurimit me mjete elektronike për procedurën e rojeve). Procedurat e prokurimit të zhvilluara në QSUT me mjete elektronike gjatë vitit 2016 janë gjithsej 85 procedura të ndara në varësi të fondit dhe llojit të procedurës së përdorur. Gjithashtu janë lidhur edhe Kontratat për procedurat e zhvilluara nga Ministria e Punëve të Brendshme në zbatim të VKM Nr.1, dt. 27.01.2015 “Për ngarkimin e Ministrisë së Punëve të Brendshme për kryerjen e procedurave të prokurimit publik” në emër dhe për llogari të Kryeministrisë, Ministrive dhe Institucioneve të varësisë për disa mallra e shërbime”. Gjithashtu janë edhe kontratat e lidhura për procedurat e zhvilluara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në zbatim të VKM 135, dt. 20.02.2013 “Për lejimin e Ministrisë së Shëndetësisë për kryerjen e procedurave të prokurimit publik në emër dhe për llogari të institucioneve të varësisë për mallra e shërbime”. Në Sektorin e Marrëdhënieve Ligjore janë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme

dhe korrekte përfaqësimi i QSUT-së në të gjitha shkallët e gjyqësorit për çështjet gjyqësore ku QSUT ka qenë palë e paditur si dhe palë paditëse, konform legjislacionit gjyqësor. Gjithashtu nga ky Sektor janë lidhur kontrata me subjektet të cilët janë shpallur fitues në Procedurat e Tenderimit të zhvilluara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrinë e Brendshme, janë lidhur gjithashtu dhe Kontrata Qiraje. Përgjatë vitit 2016 janë ndjekur shkresat e shumta ku në përgjithësi kanë në objekt kërkesën për tërheqjen e kopje karteles klinike, të gjitha këto kërkesa janë ndjekur deri në kthimin e përgjigjes.

#### 4. Njësia e Inxhinierisë Klinike

Viti 2016 për Njësinë Inxhinierike Klinike ka qenë një vit shumë intensiv dhe plot sfida. Synimi i kësaj Njësie ka qenë rritja e efektivitet të pajisjeve mjekësore në zotërim të QSUT dhe mbajtja e tyre dhe efikasitet të plotë gjatë gjithë kohës. Si pasojë e punës së bërë është arritur që gjatë vitit 2016 pajisjet mjekësore të kenë qenë në shërbim të stafit mjekësor në 95% të kohës. Sa i përket aparaturave të reja të futura në shërbim gjatë vitit të kaluar vlen të theksohet:

- Fillimi i punës së Akseleratorit Linear dhe Skanerit në Shërbimin Onkologjik.
- Instalimi dhe fillimi i punës së aparaturës mjekësore Spec-CT në departamentin e Mjekësisë Bërëdhamore.

Sa i përket mirëmbajtjes së aparaturave duhet theksuar se mirëmbajtja e aparaturave komplekse është kryer nga operatorë privat të specializuar për këto pajisje në monitorimin e stafit të NJIK ndërsa pjesa tjetër e aparaturave mirëmbahet nga stafi i NJIK. Gjatë vitit 2016 u lidhën dhe u realizuan 23 kontrata për mirëmbajtje të pajisjeve mjekësore. Dy (2) kontrata mirëmbajtje ishin mirëmbajtje e përqëndruar e pajisjeve Siemens dhe Philips. Këto kontrata ofrojnë mirëmbajtjen për 301 pajisje mjekësore komplekse.

Në Sektorin e teknologjisë së informacionit (IT) ka përfunduar realizimi i shkarkimit të barnave dhe materialeve mjekësore deri tek pacienti me sistemin informatik SISP.

Është realizuar vendosja e Time Attendance dhe Açess Card në shërbimet mjekësore. Janë instaluar kompjuterat për projektin e-Health dhe realizuar ndërveprimi i sistemit SISP me e-Health. Zyra e radiombrojtjes ka monitoruar çdo punonjës i cili punon me aparaturat mjekësore me rrezatim me anë të dozimetrave dhe janë marrë masa për mbarëvajtjen dhe sigurinë në punë. Është monitoruar importi, ndërtimi i kabinetit në Mjekësinë Nukleare dhe instalimi Spect-CT. Është realizuar projekti me IAEA për ciklin 2018-2019.

Vijon furnizimi me radioisotope sipas standardeve dhe sigurisë me IAEA vazhdim i projektit Alb 6016 me IAEA. Është realizuar procesi i marrjes së licencave për radioterapinë dhe Mjekësinë Nukleare. Ka bashkëpunuar me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për heqjen e burimit radioaktiv të kobaltit në shërbimin onkologjik.

### III. TREGUESIT SPITALOR TË QSUT


Gjatë vitit 2016 QSUT janë trajtuar një numër total prej 675.409 pacientësh, përkatësisht 78.632 të shtuar, 302.624 pacient në urgjencat e QSUT dhe si pacient ambulator (të cilët kryejnë kryesisht konsulta me mjekët e QSUT) janë trajtuar 294.153 pacient.

Pacientë	2016
Të shtruar	78.632


<b>Në Urgjencë</b>	302.624
<b>Ambulatorë</b>	294.153
<b>TOTALI</b>	<b>675.409</b>

### ***Pacientët ambulatorë***

Në grafikun në vijim paraqitet trendi i shërbimeve të ofruara ndaj pacientëve ambulatorë dhe konsultat që pacientët kanë marrë në QSUT (kujdes numri i pacientëve është 294 mijë ndërsa shërbimet që këta pacientë kanë marrë janë 430 mijë). Siç vihet re edhe nga grafiku numri i këtyre pacientëve nga 73 mijë që ka qenë në vitin 2011 ka arritur në 294 mijë pacientë ambulator në vitin 2016. Siç vihet re edhe nga grafiku rritja më e ndjeshme i takon i mëposhtëm gjatë vitit 2014 dhe 2015, ku ka një rritje të konsiderueshme të pacientëve ambulator dhe të konsultave që ofrohen nga ekipit mjekësor të QSUT.



Nëse do të vazhdojmë t'i referohemi pacientëve ambulatorë të QSUT vihet re se 83% e tyre janë të pajisur me rekomandim nga mjeku, 66% e tyre kanë qenë të siguruar dhe vetëm 20% e tyre janë detyruar të paguajnë për shkak se nuk kanë pasur të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për të përfutur sipas sistemit të referimit.



### *Ndërhyrjet kirurgjikale*

Gjatë vitit 2016 në QSUT janë realizuar në total 25.397 operacione, kjo shifër përfaqëson një rritje me 6.3% krahasuar me vitin 2015, vit në të cilin janë realizuar 23.780 ndërhyrje kirurgjikale në të gjitha shërbimet e QSUT. Tabela në vijim jep të detajuar numrin e operacioneve në të 16 sallat operatore që zotëron QSUT.

Shërbimet	Nr i Operacioneve sipas Shërbimeve viti 2016
Okulistikë	3966
ORL	1579
OMF	605
Ortopedi-trauma	1866
Onkologji	1845
Klinika I	1566
Klinika III	1965
Kirurgji urologjike	1398
Kirurgji plastike	1385
Kirurgji pediatrike	3814
Kirurgji vazale	725
Kardiokirurgji	751
Neurokirurgji	1318
Urgjenca Kirurgjikale	2614
<b>Totali</b>	<b>25397</b>

Pra siç shihet nga tabela numri më i lartë i ndërhyrjeve kirurgjikale është kryer në Okulistika ku janë realizuar 3.966 ndërhyrje e ndjekur nga Kirurgjia Pediatrike e cila ka realizuar 3.814 ndërhyrje gjatë vitit 2016.

### *Shërbimet e Urgjencave në QSUT*

Gjatë vitit 2016 në të gjithë urgjencat e QSUT kanë marrë shërbime spitalore rreth 302 mijë pacientë, prej të cilëve rreth 49 mijë janë shtruar më pas në spital me një numër total vdekjesh në këto urgjenca prej 125 pacientësh.

Vitet	Vizita	Kthime	Shtrime	Vdekje (%)
Viti 2011	157254	116709	30913	212 (0.13)
Viti 2012	168827	136307	24434	268 (0.16)
Viti 2013	192758	156540	26439	323 (0.17)
Viti 2014	246797	218967	27826	141 (0.05)
Viti 2015	258413	209426	48265	135 (0.05)
Viti 2016	302624	252977	49522	125 (0.04)

Siç vihet te nga tabela e mësipërme kemi një rritje të ndjeshme të numrit të vizitave nga urgjenca me një rritje prej rreth 14.5%. Gjithsesi fakt i rëndësishëm është që edhe pse kemi rritje të numrit të pacientëve, numri i rasteve të vdekjeve ka pësuar një ulje të lehtë krahasuar me vitin 2015.

Në vijim paraqiten të detajuara vizitat në secilën prej urgjencave të QSUT, gjatë vitit 2016.

Shërbimet e Urgjencave	Vizita	Kthime	Shtrime	Vdekje (%)
Urgjenca e Djegie-Plastikës	8119	7714	405	-
Urgjenca e Infektivit	31919	29390	2529	-
Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme	71138	51617	19396	125
Urgjenca e Specialiteteve	12668	11236	1432	-
Urgjenca Kirurgjikale	48726	44764	3962	-
Urgjenca Pediatrike	120951	100518	20433	-
Urgjenca e Psikiatrisë	9103	7738	1365	-
<b>Totali</b>	<b>302624</b>	<b>252977</b>	<b>49522</b>	<b>125 (0.04)</b>


Siç edhe shihet nga tabela numri më i madh i vizitave gjatë vitit 2016 është realizuar në Urgjencën Pediatrike i ndjekur nga Urgjenca e Sëmundjeve të Brendshme. Ndërkohë që për sa i përket rasteve të vdekjeve në urgjencë numri më i madh i tyre, me 125 raste është shënuar në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendshme.

### *Ekzaminimet imazherike*

Gjatë vitit 2016 në QSUT është realizuar një numër total prej 130.760 ekzaminimesh imazherike, me një rritje prej 8.7% krahasuar me vitin 2015.

Ekzaminimet Imazherike 2016	Totali
Rentgenoskopi	10938
Rentgenografi	36304
Ekografi	58396
Scaner	18515
Rezonance Manjetike	6607

Ndërsa po të analizojmë në detaje llojet e ekzaminimeve që kryhen në QSUT, situata do të paraqitet sipas grafikut të mëposhtëm. Rreth 44% e totalit të ekzaminimeve që kryhen në QSUT janë ekografi e ndjekur nga rentgenografi me 27% të rasteve.



### ***Ekzaminimet laboratorike***

Aktiviteti i Laboratorëve të QSUT gjatë vitit 2016 jepet i detajuar në tabelën në vijim. Në total në QSUT janë kryer 2.772.836 ekzaminimi laboratorike. Pjesa kryesore e këtyre ekzaminimeve rreth 96% është kryer në Laboratorin Biokimik-Klinik që ka kryer rreth 2.6 milion ekzaminime gjatë vitit 2016. Krahasuar me vitin 2015 ka pasur një rritje të numrit të këtyre ekzaminimeve me rreth 10%.

Nr.	Laboratorët QSUT	Nr. total i ekzaminimeve 2016
1	Laboratori Biokimik-Klinik	2,679,608
3	Laboratori Imunologjik	33,349
2	Laboratori Mikrobiologjik	22,928
4	Laboratori Anatomo-Patologjik	22,577
5	Laboratori Anatomo-Patologjik (Onkologjik)	14,374

### ***Ndërhyrjet në Shërbimin e Hemodinamikës***

Viti 2016 ka qenë viti i parë që në QSUT filloi të aplikohen ndërhyrjet koronarografisë 24-orë në ditë për 7 ditët e javës. Në vijim janë dhënë ndërhyrjet që janë realizuar nga ky shërbim për periudhën 2013–2016.

<b>Ndërhyrjet Koronarografi</b>	<b>Viti 2013</b>	<b>Viti 2014</b>	<b>Viti 2015</b>	<b>Viti 2016</b>
<b>Angiografi Koronare</b>	1833	2547	3093	3358
<b>Angioplastikë Koronare</b>	527	687	1024	1391
<b>Pacemaker definitiv</b>	135	134	217	234
<b>Totali</b>	<b>2495</b>	<b>3368</b>	<b>4334</b>	<b>4983</b>

Pra, krahasuar me vitin 2013 në vitin 2016 janë realizuar në total 50% më shumë ndërhyrje invazive. Ndërsa krahasuar me vitin 2015 janë realizuar 13% më tepër ndërhyrje invazive nga ana e këtij Shërbimi. Rritja e numrit të këtyre ndërhyrjeve ka ulur ndjeshëm kohën e pritjes nga ana e pacientëve për realizimin e këtyre lloj ndërhyrjesh.

### ***Aktiviteti Farmaceutik***

Gjatë vitit 2016 në total në QSUT është konsumuar një sasi medikamentesh që kap vlerën prej 2.851.636.522 lekë, sasi e cila është rreth 3% më shumë se sasia e konsumuar në vitin 2015.

<b>Aktiviteti farmaceutik</b>	<b>në vlerë ( në Lekë)</b>
<b>Viti 2013</b>	2,271,647,138.37
<b>Viti 2014</b>	2,563,423,743.69
<b>Viti 2015</b>	2,765,423,944.88
<b>Viti 2016</b>	2,851,636,522.07

Gjatë vitit 2016 vlen të theksohet se janë rritur konsumi i barnave të citostatikëve si dhe janë prokuruar dhe blerë barna për Stroke Unit dhe ERCP duke mundësuar një trajtim më efektiv në trajtimin e diagnozave të trajtuara në shërbimet e QSUT-së.